



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

06/593/00-364
22.01.2018

PËR/ZA/TO	z. Behxhet Pacolli Ministër i Punëve të Jashtme	DATE DATUM DATE	22.01.2018
		Reference	
NGA/OD/FROM	Drita Millaku Deputete e GP Lëvizja VETËVENDOSJE! <i>D. Millaku</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Pyetja Parlamentare:

Z.Ministër kohëve të fundit sipas disa publikimeve të vendimeve tuaja keni marrë masa ndaj përfaqësuesve diplomatik që kanë bërë shkelje apo skandale në këtë rast çfarë masa do të merrni ndaj skandalit të Konzulit të Kosovës në Frankfurt?



KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVË
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKËS KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Propozitese Komisioni i Propozimeve dhe Propoziteseve / Office
Nr. Prot. 06/691/Do-425
Prat. No. 09.02.2018
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj	DATE DATUM DATE	09.02.2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	z. Albulena Haxhiu, deputete e GP Lëvizja VETËVENDOSJE! <i>[Signature]</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.


Arsyetimi:

Një njoftimin për medie, të datës 07.02.2018, të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, thuhet se zëvendëskryeministri dhe Ministri i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Delibor Jevtiq, gjatë vizitës që ka pasur në Ministrinë Amerikane të Mbrojtjes- Pentagon, është shprehur kundër transformimit të FSK'së në Ushtri.

Sipas këtij njoftimi thuhet se " Jevtiq edhe njëherë përsëriti qëndrimin e Listës Serbe për formimin e Ushtrisë së Kosovës, duke theksuar se Lista Serbe nuk do të votojë për një gjë të tillë në Kuvendin e Republikës së Kosovës"

Pyetja Parlamentare:

A jeni në dijeni që në vizitat zyrtare, zëvendësi juaj dhe Ministri i Qeverisë që ju drejtoni, përfaqëson qëndrimet e subjektit të tij politik rrjedhimisht Serbisë dhe jo qëndrimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	Kryeministër i Republikës së Kosovës z.Ramush Haradinaj	DATE DATUM DATE	12.02.2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	Albulena Haxhiu- deputete e GP Lëvizja VETËVENDOSJE!		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA

Ministria e Administrimit të Pushtetit lokal në bashkëpunim me ABGJ- Agjensioni për Barazi Gjinore, me anë të një shkrese, iu është drejtuar komunave të Kosovës, dhe ka kërkuar që të respektohet Ligji për Barazi Gjinore për organet vendimmarrëse në nivelin lokal.

Pyetja parlamentare

A është dërguar shkresa e njëjtë edhe në Qeverinë e Republikës së Kosovës?




REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVO

06/778/00-473

27.02.2018

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

	Kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj	DATE DATU	27.02.2018
		Reference	
	Rexhep Selimi - deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE! 		
SUBJE KTI	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA

Sicc jemi në dijeni dhe sicc është konfirmuar zyrtarisht nga Komisioni Shtetëror, Kosova nga Marrëveshja e nënshkruar nga IshMinistri i Jashtëm Hashim Thacçi me Malin e Zi humb 8200 km². Ju keni pretenduar se i keni hapur rrugë korrigjimit të kësaj humbje.

PYETJA

Sa kilometra katrorë saktësisht i rikthehen Republikës së Kosovës me këtë iniciativën tuaj të re për marrëveshjen më Malin e Zi? Dhe ku, në cilin territor janë të shtrira këto kilometra katror?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

06/779/0-474
27.02.2018

	<i>Kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj</i>	DATE DATA	27.02.2018
		Reference	
	Shemsi Syla - deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE		
SUBJEKTI	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA

Lidhur me kontrollin e kufirit midis Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi

PYETJA

Aktualisht ku janë të vendosur Policia e Republikës së Kosovës në kufirin midis Kosovës dhe Malit të zi dhe deri në cilën pikë (kordinatë) ushtrojnë kontrollin e tyre efektiv?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

06/777/00-472

27.02.2018
PRISTINA - PRISTINA

	Kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj	DATE DATU	27.02.2018
		Reference	
	Samir Kurteshi - deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJEJ		
SUBJE KTI	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA

Vija kufitare midis dy vendeve midis të tjerave paraqitet në listën e pikave kordinative. Ato përbëjnë në instancë të fundit përshkrimin e saktë të vijës kufitare. Nga z. Kryeministri nuk kemi dëgjuar të flitet për to.

PYETJA

Pse nuk i shënoni kordinatat e vijës kufitare midis Kosovës dhe Malit të Zi që përbëjnë korrigjimin e gabimit prej 8200 ha në dëm të territorit të Kosovës në dokumentet zyrtare dhe në projektligjin që i keni sjellë sërish Kuvendit?



REPUBLIKES SE KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIQUE DU KOSOVO

06/446/90-390
20.12.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	Ministrin e Zhvillimit Ekonomik z. Valdrin Lluka	DATE DATU M	20.12.2017
SUBJE KI PRED MET SUBJE CT	Pyetje parlamentare për përgjigje me gojë	DATE Reference	<i>[Signature]</i>
	Avdullah Hoti - Deputet i Grupit Parlamentar të LDK-së		

Në bazë të Nenit 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja: Më 24 maj 2017, disa javë para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, Kopania Z-Mobile dhe PTK nënshkruan marrëveshje me anë të së cilës kompania Z-Mobile heq dorë nga zbatimi i vendimit të Gjykatës së Arbitrazhi. Sipas këtij vendimi, PTK i detyrohet kësaj kompanie një shumë prej 32 mil euro. Sipas deklarimeve në medie, bazuar në këtë marrëveshje të re, Z-Mobile do të marrë nga Vala edhe 100 mijë numra dhe shërbimin 3G dhe 4G. Ndërkaq, PTK do të paguajë shpenzimet e gjyqit që nuk dihet se sa janë dhe çfarë përfshijnë.

PYETJA: A keni kërkuar informata nga Bordi i PTK-së për këtë marrëveshje? Si e vlerësoni ju këtë marrëveshje? A jeni të bindur se kjo marrëveshje është në interesin më të mirë të PTK-së si kompani dhe të Qeverisë si aksionare?



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
PRISTINA

06/445/10-309

20.12.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR/ZA/TO	Ministrin e Financave, z. Bedri Hamza	DATE DATUM DATE	20.12.2017
		Reference	
NGA/OD/FROM	Avdullah Hoti - Deputet i Grupit Parlamentar të LDK-së		
SUBJEKTI FREDMET SUBJECT	Pyetje parlamentare për përgjigje me gojë		

Në bazë të Nenit 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja: Në seancën e dates 07.12.2017 Nënkyetari i Kuvendit të Kosovës z. Xhavit Haliti ndër të tjera deklaroj "Z. Kryeministër t'u kisha lut me i kontrollu Doganat e Kosovës, jo me kamera, po me mekanizma, që të kontrollohen për mallrat që hyjnë, e që kur ato hyjnë ilegalisht ndalen kamerat. Cigaret, alkooli e nafta janë kontrabanda ma e madhe që po e gërryejnë buxhetin e Kosovës"

PYETJA: Z.Minister, si e shpjegoni ju kete deklarate? Si e keni kuptuar ate? A keni biseduar me z.Haliti, duke qene se ai vjen nga subjekti i juaj politik? A ju ka ofruar z.Haliti informate dhe te dhena per rastin konkret te cilit ai i referohet? A keni kerkuar pergjigje nga Dogana e Kosoves per kete deklarim te z.Haliti?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

06/781/No-476
27.02.2018
PRISTINA

	Zwendeswskryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Fatmir Limaj	DATE DATI	27.02.2018
		Reference	
	Fitore Pacolli - deputete e GP Lëvizja VETËVENDOSJE!		
SUBJE KTI	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA

Lidhur me autorizimet për negociim me një shtet tjetër referuar Ligjit për Marrëveshjet ndërkombëtare.

Z. Zëvendeskryeministër, ju keni deklaruar dhe po ashtu zyrtarisht është e konfirmuar se keni zhvilluar biseda me autoritet e Malit të Zi, respektivisht me autoritete të Qeverisë së Malit të Zi lidhur me ccështjen e marrëveshjes së demarkacionit.

PYETJA

Në cilën cilësi i keni zhvilluar këto biseda? Cili u ka pajisur me këtë autorizim? Presidenti i Republikës apo Ministri i Jashtëm? A mund të na paraqisni shkresën zyrtare, numrin e saj dhe përmbajtjen, ku ju jipet autorizimi sipas ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare? Cfarë keni biseduar në këto takime dhe sa të tilla janë mbajtur? A mund të na i dorëzoni zyrtarisht në kuvend procesverbalet e këtyre takimeve?



Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
Zëra për Transportin dhe Infrastrukturën, Prizren, Shkup, Tërbënie, Tërbënie
Nr. i Protokollit: 06/731/Do-447
Data: 15.02.2018

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PER / ZA / TO	<i>Ministrin e Infrastrukturës, z. Pal Lekaj</i>	DATE DATUM DATE	15.02.2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	<i>Mimoza Kusari Lila – Deputete e LDK-së</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	<i>Pyetje Parlamentare</i>		


Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës së Kuvendit të Kosovës.

Çështja: Gjatë vizitës tuaj në Komunëne Gjakovës me 7 Shkurt 2018, Ministër Lekaj, ju bashkë me Kryetarin e Komunës, keni deklaruar se keni nënshkruar 5 marrëveshje për projekte të Infrastrukturës, në vlerë prej 14 milion Eurosh, përfshi këtu Ndërtimin e Qarkores së Gjakovës.

Pyetja parlamentare: 1. Ministër cilat janë katër projektet tjera të cilat i keni nënshkruar me komunën, pasi në buxhetin e miratuar të vitit 2018, projekt i ri është vetëm Qarkorja e Gjakovës dhe rruga Bërdosanë – Rezinë. Të gjitha projektet tjera të buxhetit janë të bartuara dhe të miratuar me buxhetin e vitit 2017.

Projekti i Qarkores së Gjakovës me të gjitha segmentet e veta të diskutuara, të negociuara dhe dakorduara në mes: BERZH, Komunës së Gjakovës dhe Ministrisë së Infrastrukturës në vitin 2017 është i vlerës 25 milion Euro, prej të cilave 7 milion kanë qenë obligim për financim të Komunës, ndërsa 17 milion obligim i Ministrisë së Infrastrukturës. Ministër, në buxhetin e Kosovës të miratuar për vitin 2018 bashkë me kornizën afatmesme të shpenzimeve, Qarkorja e Gjakovës është me vlerë 6 milion euro për tri vite, dmth, 2 milion euro investime në vit, nga buxheti i Kosovës.

2. A e ka në listen e investimeve strategjike me BERZH, Ministria e Infrastrukturës edhe projektin e qarkores së Gjakovës sikur ishte e planifikuar më parë, pasi me vlerat e prezantuara nuk do të arrihet as zgjerimi i hyrjeve të qytetit Gjakovës, pa përfshirë këtu shpenzimet tjera të shpronësimit dhe obligimet tjera. Pse në listen e projekteve të diskutuara me BERZH-in nuk e keni përfshirë projektin e Qarkores së Gjakovës sipas planifikimit të mëhershëm?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PER/ZA/TO	<i>Ministrin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, z.Rrustem Berisha</i>	DATE DATUM DATE	13.02.2018
		Reference	
NGA/OD/FROM	Shemsi Sylja- deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE!		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA

Bazuar në Pakon e Atisarit në Aneksin VIII – Sektori i Sigurisë në Kosovë, Nenin 5 – Forca e Sigurisë së Kosovës/paragrafin 5.2 si dhe Ligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në Nenin 10.paragrafi 10.2 përmes së cilave është themeluar FSK, përcaktohet se: *Forca e Sigurisë së Kosovës është e armatosur lehtë dhe nuk do të ketë armë të rënda, siç janë tanket, artileria e rëndë apo kapacitete sulmuese ajrore.*

PYETJA

I nderuari, Ministër Berisha,

Duke marrë për bazë Pakon e Atisarit dhe Ligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës me anë të cilave FSK përcaktohet si forcë e armatosur lehtë, si dhe duke marrë parasysh dokumentet dhe protokollet ndërkombëtare përmes të cilave definohen armët e lehta, atehere pyetja ime është:

Pse nuk është paisur asnjëhere as me armet që në fakt i ka të lejuara përtej atyre që i ka aktualisht në inventar?